



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr 167 prot

Përmët, 15/01/2026

Lënda: Dërgohet dokumentacion për shqyrtim dhe miratim

Znj Anila Dhimitri

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK PËRMET

E nderuar Zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimet, relacionet shoqëruese si dhe dokumenta të tjerë shoqërues si më poshtë:

1. P/V Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Përmët për vitet 2027-2029
2. P/V Për miratimin e kontratës së qirasë ndërmjet Bashkisë Përmët dhe subjektit Vodafone sh.a., për dhënien në përdorim të fondit kullosor 'Dhëmbel', me një sipërfaqe prej 0.1843 ha, në ngastrën nr. 27, për vendosjen e antenës së telefonisë së lëvizshme, si dhe dhënien e autorizimit Kryetarit të Bashkisë Përmët për nënshkrimin e saj."
3. Për përfundimin e procedurave lidhur me VKM-në nr. 329, datë 22.5.2019, "Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi", si dhe për lidhjen e kontratave para noterit për 2 (dy) familje
4. P/V Për miratimin e programit kulturor dhe argëtues për vitin 2026 dhe akordinin e fondit përkatës
5. P/V Për përcaktimin e kriterëve dhe familjet në nevojë nga fondi 6% dhe fondi i bashkisë
6. P/V Për miratimin të ndihmës ekonomike për familjet në nevojë, muaji dhjetor 2024.

Sheshi "Abdyl Frashëri", tel.+35581322254;ëeb:ëëë bashkiapermet.gov.al;e-mail:info@bashkiapermet.gov.al

7. P/V Për miratimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmë ekonomike deri në 6%.
8. P/V. Për një ndryshim në VKB-në nr. 116, datë 17.12.2025, 'Për miratimin e nivelit të pagave dhe shpërblimeve të punonjësve dhe të personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar të Bashkisë Përmet dhe të institucioneve që varen prej saj, për vitin 2026

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET**

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë _____, 2026

PËR

**VLERËSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE TË
BASHKISË PËRMET PËR VITET 2027-2029.**

Në mbështetje të neneve 8,9,34-37,54,shkronja "F", 55 pika 3 të Ligjit nr.139/2015,date 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore",kreu III,nenit 34 pika 1-3 të ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore",Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë",i ndryshuar,Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar,Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë",i ndryshuar,Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",i ndryshuar,Udhëzimin nr.7 datë 28.02.2018 të Ministrisë së Financave "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm",Këshilli i Bashkisë,me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

- 1.Të miratojë vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Përmet për vitet 2027-2029 sipas dokumentit bashkëlidhur.
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë Përmet,Njësi Administrative dhe Institucioneve të Varësisë.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA



Sheshi "AbdylFrashëri", tel.+35581322254,e-mail:info@bashkiapermet.gov.al

Te ardhurat afatmesme Bashkia Permet vitet 2026-2028

000 lek

NR	LLOJI I TE ARDHURAVE	Realizim 2024	Realizim 2025 Viti 2025	Planifikim Viti 2026	Planifikim Viti 2027	Planifikim Viti 2028	Planifikim Viti 2029
A	TE ARDHURA TATIMORE	24293	35174	37492	44960	44980	44980
1	Taksa mbi ndertesat	7418	10720	12795	15000	15000	15000
2	Taksë mbi truallin	1500	1346	1551	1900	1900	1900
3	Tatim I thjeshtuar mbi fitimin	153	44	0	0	0	0
4	Takse e ndik.infr.nd.reja dhe legalizimet	1331	8112	7000	10780	10790	10790
5	Takse mbi kalimin e te drejtes se prones.	414	112	200	1480	1490	1490
6	Takse Rregjistrim automjeti	6282	6965	6200	8000	8000	8000
7	Takse Tabele	301	420	623	400	400	400
8	Taksë mbi tokën bujqësore	1653	2611	3623	2200	2200	2200
9	Taksë fjetje në hotel	289	307	1000	500	500	500
10	Tatim mbi të ardhurat personale	5050	4528	4500	4700	4700	4700
11	Takse shitje pasuri e paluajtshme	0	9	0			
B	TE ARDHURA JOTATIMORE	33633	42183	52943	55920	56145	56145
1	Tarife Pastrimi	14284	15821	23871	20000	20000	20000
2	Tarife Ndricimi	4037	4358	5790	9000	9000	9000
3	Tarife Gjelberimi	1955	2354	2950	6000	6000	6000
4	Leje Rregjistrim Veprimtarie	1094	1836	600	1500	1500	1500
5	Qera Objekti	0	0	0	0	0	0
6	Te ardhura nga Cerdhja Kopshti	1831	1268	2693	2345	2350	2350
7	Tarife Parkimi	60	80	150	1000	1000	1000
8	Tarifë për lëndë drusore	589	1405	1161	835	840	840
9	Tarifë zënie hapësirë publike	1178	1513	907	1200	1200	1200
10	Tarifë kullotje bagëtije	1130	1223	2500	2500	2500	2500
11	Tarifë mirëmbajtje kanale vaditës	233	266	300	800	1000	1000
12	Të ardhura nga qiraja për troje	2818	4862	7425	5700	5700	5700
13	Tarifa vendore nga urbanistika	1145	4445	4000	2150	2160	2160
14	Tarifa shërbimesh të MNZ	45	59	200	145	150	150
15	Te tjera te ardhura	1467	368	396	2745	2745	2745
16	Sponsorizime	1767	1245	0	0	0	0
17	Zhdemtime e kamatvonesa	0	1080	0	0	0	0
	Të ardhura vjetore	57926	77357	90435	100880	101125	101125





RELACION

Vlerësimi dhe parashikimi afat mesëm i të ardhurave të veta të Bashkisë Përmet 2027-2029

Të ardhurat e veta përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës nga burimet qendrore. Këto burime të ardhura bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Përmet, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, detajon çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administrimit, përcakton qartë edhe administrimin e saj duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj.

Paketa fiskale e Bashkisë Përmet për këtë kategori e hartuar dhe e ndryshuar edhe me përfshirjen e përfaqësuesve të komunitetit të biznesit e më konkretisht biznesit të madh dhe të vogël, banorë vetë njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit, këshilltarë etj., pasqyron disa politika të rëndësishme për uljen e disa niveleve ligjore /kufi, etj. Sipas kompetencave ligjore, si më poshtë:

Politikat incentiveuese në taksa:

- Taksë 0 (zero) ndërtese për qëllime banimi për invalidët kryefamiljarë.
- Taksë 0 (zero) ndërtese për familjet e pensionistëve .

Politikat incentiveuese dhe uljet nën nivelet e kostos së shërbimit të llogaritur:

- Tarifa e pastrimit 0 (zero) për familjet me ndihmë ekonomike, e sociale
- Tarifa e pastrimit 0 (zero) për familjet e pensionistëve me të ardhura mujore nën 30.000 lek.
- Tarifa 0 (zero) për familjet me kryefamiljarë invalidë, të paaftë, veteranë e të verbër.

Procesi i planifikimit të të ardhurave të veta u realizua në bashkëpunim me administratën e bashkisë, me Njësitë Administrative, me Institucionet e Agjentët tatimorë, etj. Vazhdimi i këtij procesi bashkëpunues do të mundësojë sigurimin e të ardhurave, me efekt përmirësimit e

mëtejshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorin e bashkisë.

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat, të ardhurat nga tarifat dhe të ardhurat nga burimet e tjera.

Zërat e taksave dhe tarifave që ndikojnë pjesën më të madhe të planit të të ardhurave nga burimet e veta në vitin 2027 që perkon dhe me vitin buxhetor për vitin e ardhshëm, janë kryesisht tarifat për pastrimin që zë rreth 19.8% të tij, taksa e pasurisë së paluajtshme që zë rreth 18.9%, taksa e ndikimit në infrastrukturë që zë rreth 10.7%, taksa e mjeteve të përdorura që zë rreth 7.9%, tarifa e ndriçimit publik që zë rreth 8.9%, tarifa e gjelbërimit që zë rreth 5.9 %, tarifa për kullotje bagëti e që zë rreth 2.5 %. Këto zëra kryesorë mbulojnë rreth 74.7 % të planit të të ardhurave të Bashkisë Përmet. E njëjta situatë paraqitet pak a shume edhe për dy vitet e tjera planifikuese. Administrata e Bashkisë ka pasur parasysh që në ndryshimet e paraqitura për zërat e të ardhurave që lidhen me pasurinë e paluajtshme (takes trualli, takes ndërtese dhe taksa e tokës bujqësore) do të ndikojë zgjerimi i bazës së taksa paguesve nëpërmjet:

- Saktësimi dhe vlerësimi të drejtës i përfaqësuesve nëpërmjet grupeve të punës të ngritura për këtë qëllim,
- Mbështetja nga agjentë tatimorë,
- Ndarjes në këstet e pagesave, (për taksën e ndërtesës për popullatën)
- shtrirje e mëtejshme e bazës taksa paguese, falë politikave fiskale lehtësuese dhe incentivave të ndërmarra, rivlerësimi të gjendjes faktike, përmirësimi të shërbimit dhe marrëdhënies me taksa paguesin, si dhe bashkëpunimit të pritsëm me institucionin ASHK.

Ndryshimi në zërin e Taksës së ndikimit në infrastrukturë paraqet potencialin për dhënien e lejeve të ndërtimit pas hartimit të PPV dhe kërkesave të paraqitura deri më tani.

Për sa i takon tarifave të tjera vendore nuk janë paraqitur ndryshime esenciale në parashikimet për vitet 207-2029

- pasi nga të dhënat statistikore që Zyra e Tatim Taksave ka në arritjet e kapaciteteve paguese (shtim të familjeve apo të bizneseve).
- Është bërë ndryshim me rritje për Taksën e Truallit bazuar në realizimin e vitit 2025 dhe nga zgjerimi i bazës së taksapaguesve.
- Është bërë ndryshim me rritje për tarifen e gjelbërimit bazuar në realizimin e vitit 2025, dhe planifikim për rritje të sipërfaqeve të gjelberta ,hapësira shlodhese në qytet .

Tabela e më poshtme pasqyron planin e të ardhurave të veta, të kategorizuar si pas klasifikimit ekonomik ligjor:

Ju faleminderit!

Përgjegjësi Tatim – Taksave
Dorjan METKO
SEKRETARIA
BASHKIA PËRMET



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET**

Nr. _____ Prot.

Përmet, më _____.2026

P/VENDIM

Nr. _____ datë _____.2026

PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR 116 DATË 17.12.2025 "PER MIRATIMIN E NIVELIT TE PAGAVE DHE SHPERBLIMEVE TE PUNONJESVE E TE PERSONAVE TE TJERE TE ZGJEDHUR OSE TE EMERUAR TE BASHKISE PERMET DHE TE INSTITUCIONEVE QE VAREN PREJ SAJ PER VITIN 2026"

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore ", neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak", pika ç, VKM nr 776 datë 19.12.2025 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", referuar shkresës nr. 3757 prot, datë 11.11.2025 për transfertën e pakushtëzuar për vitin 2026, VKB NR.113 datë 17.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë, Njësive Administrative dhe institucioneve në varësi të saj, VKN nr 116 datë 17.12.2025 "Per miratimin e planit te punes, planit te konusltimeve dhe planit te buxhetit te Keshillit te Bashkise Permet per vitin 2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

- 1.Të zbatohet paga minimale mujore për punonjësit e Bashkisë dhe Njësive të Varësisë në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe shtesat e tjera mbi pagë.
- 2.Të zbatohet paga minimale mujore në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë për të gjithë Punonjësit Administrativë që janë trajtuar sipas pikës 11 dhe 12 të VKM NR 328, datë 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar ,të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të Vetëqeverisjes Vendore", ndryshuar me VKM nr 503.
- 3.Të zbatohet niveli i pagave për pozicionet si më poshtë:
 - Pozicioni Shef i Policisë Bashkiake të jetë i njëvlefshëm me pozicionin e Kryeinspektorit klasa III 2 me pagë pozicioni 90.000 lekë në muaj .
 - Pozicioni Polic Bashkiak të jetë i njëvlefshëm me pozicionin e inspektorit klasa IV 3 ,me pagë pozicioni 70.000 lekë në muaj .



-Pozicioni Polic Bashkiak me arsim të mesëm të jetë i njëvlefshëm me pozicionin e specialistit klase IV 4 me pagë prej 60.000 lekë në muaj (vjetersia 1%. mbi pagën bazë të përcaktuar, sipas pikës 12 të VKM nr 503

4.Efektet financiare do të përballohen nga fondi i veçantë i planifikuar në Buxhetin e Vitit 2026.

5.Ngarkohet Titullari i Bashkisë për miratimin e strukturës së Bashkisë me ndryshimet përkatëse.

6.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Financë Buxhet, Burime Njerëzore dhe sheërbimeve mbështetëse.

7.Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BASHKISË
ALMA HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ Prot. _____

Përmët, më _____ 2026

RELACION

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak", pika ç, VKM nr 776 datë 19.12.2025 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", referuar shkresës nr. 3757 prot, datë 11.11.2025 për transfertën e pakushtëzuar për vitin 2026, VKB NR.113 datë 17.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë, Njësive Administrative dhe institucioneve në varësi të saj, VKB NR.116 datë 17.12.2025 "Per miratimin e nivelit të pagave dhe shperblimeve te punonjesve e te personave te tjere te zgjedhur ose te emeruar te Bashkise Permet dhe te institucioneve qe varen prej saj per vitin 2026. i propozojmë Këshillit Bashkiak për zbatimin e nivelit të pagave", si më poshtë:

-Zbatimin e pagës minimale mujore për punonjësit e Bashkisë dhe Njësive të Varësisë në shumën 50.000(pesëdhjetë) mijë lekë.

1.Numri i punonjësve me pagë minimale është 167 përkatësisht si më poshtë:

Aparati-3 Punonjës,Çerdhja-8 Punonjes,Kopshti-13 Punonjës, Arsim i mesëm-5 Punonjës, Sektori i Përfshirjes Sociale-2 Punonjes, Sektori i Kulturës-11 punonjës, Njësia e Mbetjeve-30 punonjës, Njësia e Gjellbërimit-21 punonjës, Njësia e Shërbimeve-22 Punonjës, Njësia e Mirëmbajtjes së Kanaleve Kulluese-6 punonjës, Njësia e Rrugëve Rurale-32 Punonjës, Sektori Pyje kullota – 7 Punonjës, Njësitë Administrative-6 Punonjës,MZSH-1 Punonjes

2.Bazuar në VKM nr 328 datë 31.05.2023,ndryshuar me VKM nr 503 datë 01.08.2024, pika 11 me të cilën trajtohen punonjësit administrative nuk është ndryshuar.Për këtë arsye të gjithë këta punonjës që janë trajtuar sipas kësaj pike aktualisht do të trajtohen sipas VKM nr 776 datë 19.12.2025 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".

Numri i punonjësve administrativë është 18 përkatësisht si më poshtë:

Aparati-4 punonjës, Policia Bashkiake-2 Punonjës, Arsim i mesëm-1, Sektori i Përfshirjes Sociale-1, Njësia e Mbetjeve-3 punonjës, Njësia e Gjellbërimit-2 punonjës, Njësia e Shërbimeve-

1 Punonjës, Njësia e Mirëmbajtjes së Kanaleve Kulluese-1 punonjës. Njësia e Rrugëve Rurale-3 Punonjës

Numri total i punonjësve me pagë minimale dhe punonjësve administrative është 185.

2.1 Sipas pikës 12 të VKM nr.503 datë 01.08.2024 "Për klasifikimin e funksioneve ,grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore,për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur dhe të emeruar , të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore" shtesa mbi pagë do të jetë 1% mbi pagën bazë të përcaktuar për çdo klasë.

3.Në zbatim të pikës 9 të VKM nr.328 datë 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore,për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur dhe të emeruar , të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore" ndryshuar me VKM nr.503 datë 01.08.2024 "Për klasifikimin e funksioneve ,grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore,për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur dhe të emeruar , të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore" sugjerojmë që :

-Pozicioni Shef i Policisë Bashkiake të jetë i njëvlefishëm me pozicionin e Kryeinspektorit klasa III 2 me pagë pozicioni 90.000 lekë në muaj .

-Pozicioni Polic Bashkiak të jetë i njëvlefishëm me pozicionin e inspektorit klasa IV 3 ,me pagë pozicioni 70.000 lekë në muaj .

-Pozicioni Polic Bashkiak me arsim të mesëm të jetë i njëvlefishëm me pozicionin e specialistit klasa IV 4 me pagë prej 60.000 lekë në muaj (vjetërsia 1%. mbi pagën bazë të përcaktuar,sipas pikes 12 të VKM nr 503 datë 01.08.2024)

4.Efektet financiare për 167 punonjës janë përlllogaritur në buxhetin e vitit 2026,dhe i është dërguar Ministrisë së Financave shkresa me nr 3861 prot, datë 17.11.2025"Kërkesë për burime shtesë"për punonjësit e tjerë.

5.Ngarkohet Titullari i Bashkisë për miratimin e strukturës së Bashkisë me ndryshimet përkatëse.

6.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Financë Buxhet,Burime Njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse.

7.Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi: *X. Xipi*
Miratoi: *Z. Xaxhi*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ Datë _____ 2026

PËR

**"MIRATIMIN E KONTRATËS SË QIRASË NDËRMJET BASHKISË PËRMET DHE
SUBJEKTIT VODAFONE SH.A PËR DHËNIE NË PËRDORIM TË FONDIT
KULLOSOR, TË NJË SIPËRFAQE PREJ 0.1843 HA, NË NGASTRËN NR 27 TË
EKONOMISË KULLOSORE "DHËMBEL'PËR VËNIE ANTENE TË TELEFONISË
SË LËVIZËSHME SI DHE DHËNIEN E AUTORIZIMIT TË KRYETARIT TË
BASHKISË PËR NËNSHKRIMIN E SAJ"**

Në zbatim Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, të Ligjit Nr.57/2020 "Për Pyjet", të ndryshuar, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kulloros", të ndryshuar, si dhe të nenit 801 e ne vijim të ligjit Nr. 7850 date 29.07.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", VKM Nr.433 datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kulotave publike", e ndryshuar, V.K.M nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/Përdorim të Fondit Pyjor Kombëtar, për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore e jodrusore pyjore", e ndryshuar si dhe Udhëzimit të Ministrisë nr.1, datë 09.03.2016, "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kulloros publik", Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.107 datë 04.12.2025 "Për miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes totale prej 0.1843 ha për ndërtimin e antenës së lëvizshme dhe ndërtime të tjera ndihmëse nga shoqëria Vodafone Albania Sh.a, njësisë Administrative Piskovë, Bashkia Permet i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 1047/1 Prot, datë 22.12.2025, kërkesën nr.3127, datë 25.09.2025, të shoqërisë "Vodafone Albania"SHA, Urdhërin nr.478, datë 10.11.2025, të Kryetarit të bashkisë Permet "Për hartimin e raportit tekniko-ekonomik, për dhënie në përdorim të sipërfaqes kullosore", Raportin e vlerësimit Tekniko-Ekonomik, hartuar nga grupi i punës ngritur me Urdhër Nr.478 datë 10.11.2025, të Kryetarit të Bashkisë si dhe bazuar në relacionin e paraqitur e me propozim të Kryetarit të Bashkisë ,

VENDOSI:

1. Miratimin e Kontratës së Qirasë ndërmjet Bashkisë Permet dhe Vodafone Sh.a me objekt dhënie në përdorim të një sipërfaqe prej 0.1843 ha, në Ekonominë Kullosore "Dhëmbel", ngastrë nr.27, e cila pozicionohet në zonën kadastrale Nr.3153, me numër pasurie 257 në pronësi të Bashkisë Permet, për vendosje antene të telefonisë së lëvizshme dhe ndërtime të tjera ndihmëse ,nga shoqëria "Vodafone Albania"SHA.
2. Vlera vjetore e dhënies në përdorim me kontratë qiraje, të jetë sipas vlerësimit të raportit tekniko-ekonomik, bazuar në V.K.M nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/Përdorim të Fondit Pyjor Kombëtar, për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore e jodrusore pyjore", e ndryshuar, shtojca nr.1, pika 7,8 dhe 11.



3. Fillimet e punimeve për ndërtimin e stacionit, për hapjen e rrugës së re ndihmëse si dhe për implementimin e linjës elektrike TM të nevojshme do të bëhen pas pajisjes së subjektit me lejen përkatëse të ndërtimit.
4. Afati dhënies në përdorim është 9 vjet nga data e nënshkrimit të kontratës nga të dyja palët.
5. Të drejtat dhe detyrimet e palëve janë sipas përshkrimit në kontratë.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit të Territorit, Sektorit Juridik e Prokurimeve dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësi, Turizëm.
7. Ky vendim, pas miratimit nga ana e këshillit Bashkiak Përmet, hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

KRYETARI I BASHKISË
Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

RELACION

PËR

**"MIRATIMIN E KONTRATËS SË QIRASË NDËRMJET BASHKISË PËRMET
DHE SUBJEKTIT VODAFONE SH.A PËR DHËNIE NË PËRDORIM TË FONDIT
KULLOSOR ,TË NJË SIPËRFAQE PREJ 0.1843 HA,NË NGASTRËN NR 27 TË
EKONOMISË KULLOSORE "DHËMBEL'PËR VËNIE ANTENE TË TELEFONISË
SË LËVIZËSHME SI DHE DHËNIEN E AUTORIZIMIT TË KRYETARIT TË
BASHKISË PËR NËNSHKRIMIN E SAJ"**

Përmet, më _____.2026

Në zbatim Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"i ndryshuar,të Ligjit Nr.57/2020 "Për Pyjet",të ndryshuar, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullor", të ndryshuar, si dhe të nenit 801 e ne vijim të ligjit Nr. 7850 date 29.07.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", VKM Nr.433 datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kulotave publike", e ndryshuar, V.K.M nr.559,datë 29.07.2022"Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/Përdorim të Fondit Pyjor Kombëtar,për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore e jodrusore pyjore",e ndryshuar si dhe Udhëzimit të Ministrit nr.1, datë 09.03.2016, "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik", Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.107 datë 04.12.2025 "Për miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes totale prej 0.1843 ha per ndërtimin e antenës së lëvizshme dhe ndërtime te tjera ndihmëse nga shoqëria Vodafone Albania Sh.a, njësia Administrative Piskovë, Bashkia Permet i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastr me shkresën nr. 1047/1 Prot, datë 22.12.2025, kërkesën nr.3127,datë 25.09.2025,të shoqërisë "Vodafone Albania"SHA,Urdhërin nr.478,datë 10.11.2025,të Kryetarit të bashkisë Përmet"Për hartimin e raportit tekniko-ekonomik,për dhënie në përdorim të sipërfaqes kullorore",Raportin e vlerësimit Tekniko-Ekonomik,hartuar nga grupi i punës ngritur me Urdhër Nr.478 datë 10.11.2025,të Kryetarit të Bashkisë.

Shoqëria "Vodafone Albania"SH.A,në datë 25.09.2025 ka paraqitur pranë bashkisë Përmet kërkesë ,të regjistruar me numër protokolli 3127 , date 25.09.2025 për vendosjen e një antene të telefonisë së lëvizëshme në afërsi të fshatit Rapckë,njësia administrative Piskovë,zona kadastrale nr.3153,me numër pasurie 257 në një sipërfaqe prej 0.1843 ha toke me status kullorë publike,nga të cilat 0.01 ha do të përdoren për vendosjen e antenës,0.0243 ha për ndërtimin e 81 ml rrugë, për lidhjen me rrjetin rrugor egzistues dhe 0.15 ha do të përdoren për ndërtimin e linjës së re elektrike për lidhjen me rrjetin egzistues.

Bashkëngjitur kërkesës për marrje në përdorim të sipërfaqes së mësipërme,shoqëria "Vodafone Albania"SHA ka dorëzuar dhe dokumentat e mëposhtme.

1. Kopje të ekstraktit QKB të subjektit.



2. Kopje të dokumentacionit të ushtrimit të aktivitetit.
3. Prokurë
4. Plan topografik të sipërfaqes së kërkuar në shkallë 1:10000.
5. Pamje të antenës.
6. Planimetri të antenës.
7. Gjurmën e linjës elektrike.
8. Projektin e rrugës.

Plotësuar pas miratimit të VKB Nr.107 datë 04.12.2025 :

9. Vendim për VNM Paraprake me Nr. AN211020250095 datë 11.12.2025, Komisioni 162, dhënë nga Drejtoria e Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Ministria e Mjedisit.

Grupi i punës përbërë nga përfaqësuesit e bashkisë Përmet, pas inspektimit në terren, konstaton se:

- Sipërfaqja e kërkuar ndodhet në ngastrën numër 27 të ekonomisë kullimore "Dhëmbel"
- Sipërfaqja e kërkuar ndodhet në një zonë kullimore që nuk ndikon në kullotjen e bagëtive të komunitetit lokal;
- Vendosja e antenës nuk çonon rrjedhën e ujërave, kufijtë e pronës publike apo të banorëve;
- Investimi është me ndikim pozitiv për komunitetin, për komunikimin dhe emergjencat civile;
- Kompania do të ndërtojë objektin sipas standarteve teknike dhe mjedisore në fuqi.

Përfitimet:

- Përmirësimi i mbulimit me sinjal telefonik dhe internet të zonës, e cila aktualisht ka sinjal të dobët ose të munguar.
- Të ardhura shtesë për bashkinë Përmet.

Propozimi:

Në bazë të sa më sipër, propozohet që Këshilli Bashkiak i Bashkisë Përmet të miratojë.

- Dhënjën në përdorim për një afat 9 vjeçar të një sipërfaqe prej 0.1843 ha, të ngastrës numër 27 „Ekonomia Kullimore”Dhëmbel”, në afërsi të fshatit Rapckë, njësie administrative Piskovë.
- Përdorimi i sipërfaqes të bëhet vetëm për qëllimin e përcaktuar dhe pa të drejtë nënshfrytëzimi;
- Kompania të paguajë tarifën vjetore të përdorimit sipas përcaktimeve në kontratën përkatëse.

Ju faleminderit!

PËRGATITI:

Përgjegjësi i Sektorit Bujqësi-Turizëm

Ing. Bledar Vesho

Përgjegjës i Sektorit Juridik

Enea Kushe



Sheshi "Abdyl Frashëri" ; tel.+35581322254 e-mail info@bashkiapermet.gov.al www.bashkiapermet.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ Datë _____. _____. 2026

PËR

“PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE LIDHUR ME VKM-NË NR. 329, DATË 22.5.2019, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË BASHKËRENDIMIT TË PUNËS SË BASHKIVE ME AGJENCINË SHTETËRORE TË KADASTRËS, PËR REGJISTRIMIN E TROJEVE TË DHËNA PËR NDËRTIM NGA NJËSITË E QEVERISJES VENDORE DHE PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE JURIDIKE TË PRONËSISË MBI KËTO TROJE, PËR EFEKT REGJISTRIMI” DHE PËR LIDHJEN E KONTRATAVE PARA NOTERIT PËR 2 (DY) FAMILJE.

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM Nr.329, datë 22.5.2019, “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi” dhe në Ligjin Nr.7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” neni 83 i tij, si dhe bazuar në relacionin e paraqitur e me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të përfundohen procedurat për lidhjen e kontratës së shitjes së truallit të noteri lidhur me VKM Nr.329 datë 22.05.2019 për 2 (dy) familjet si më poshtë :
 - a) Ylli MAKOLLARI
 - b) Kastriot STERJO
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Urbanistikës/Planifikimit të Territorit/Sektorit Juridik dhe Prokurimeve.
3. Ky vendim, pas miratimit nga ana e këshillit Bashkiak Përmet, hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

KRYETARI I BASHKISË
Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Përmet, më __. __. 2026

RELACION
PËR

“PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE LIDHUR ME VKM-NË NR. 329, DATË 22.5.2019, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË BASHKËRENDIMIT TË PUNËS SË BASHKIVE ME AGJENCINË SHTETËRORE TË KADASTRËS, PËR REGJISTRIMIN E TROJEVE TË DHËNA PËR NDËRTIM NGA NJËSITË E QEVERISJES VENDORE DHE PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE JURIDIKE TË PRONËSISË MBI KËTO TROJE, PËR EFEKT REGJISTRIMI” DHE PËR LIDHJEN E KONTRATAVE PARA NOTERIT PËR 2 (DY) FAMILJE”.

KËSHILLIT TË BASHKISË

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Bashkisë,

Pranë Bashkisë Përmet janë paraqitur kërkesa nga qytetarë të ndryshëm mbi regjistrimin e pronave të tyre, objekt i VKM-së Nr.329, datë 22.5.2019, “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi”.

Objekt i këtij vendimi janë tokat e dhëna për qëllime ndërtimi nga bashkitë, ish-komunat dhe ish-këshillat e rretheve (në vijim të quajtura "organe vendore"), pas datës 10.8.1991 deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 24/2012, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10270, datë 22.4.2010, "Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij”.

Shqetësimi i këtyre qytetarëve vjen për shkak të mosregjistrimit të kësaj kategorie pranë Drejtorisë Vendore të ASHK-së për arsye se mungon kontrata e shitjes e lidhur përpara noterit publik dhe në përputhje me përcaktimet e bëra në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, Neni 83 i tij citon : *“Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm. Është i pavlefshëm veprimi juridik që nuk është bërë në formën e kërkuar shprehimisht nga ligji”.*



Kjo VKM ka për qëllim heqjen e kufizimeve nga regjistri i pasurive të paluajtshme dhe regjistrimin e tyre në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

Kanë të drejtë të përfitojnë nga dispozitat e këtij vendimi të gjitha subjektet për të cilat është miratuar të paktën vendimi i këshillit të organit vendor për dhënien e truallit për ndërtim.

Kjo procedurë nis me kërkesë të subjektit të interesuar duke paraqitur gjithë dokumentacionin që ai disponon lidhur me këtë truall, dhe Bashkia vazhdon me shqyrtimin e dokumentacionit rast pas rasti, duke ngritur një grup pune i cili do të merret me, plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, Akt-Vlerësimin, Relacionin, Vendimin dhe Kontratën.

Njësia përgjegjëse për ndjekjen e procedurës për regjistrimin dhe rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë për trojet e dhëna për ndërtim, pasi ka verifikuar të gjitha dosjet e kërkuësve dhe i ka plotësuar ato, paraqet materialin në Këshillin e Bashkisë për miratim sipas tabelës:

Nr.	EMËR MBIEMËR	ADRESA
1	YLLI MAKOLLARI	Lagjja Skutaraq, Përmet
2	KASTRIOT STERJO	Lagjja Bajame, Përmet

Për sa më sipër, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë Përmet, që të votojë pro miratimit të këtij projekt-vendimi sipas materialit që gjenden në dosjen e secilit këshilltar.

Bashkangjitur do të gjeni;

1. Z.Ylli MAKOLLARI

1. Kërkesa e z.Ylli Makollari, Nr 3703 Prot, datë 06.11.2025.
2. Fotokopje e kartës së identitetit .
- 3.Kontratë Shitje Trualli , datë 21.06.2005.
- 4.Vendim Nr.10 datë 04.03.2005 i K.RR.T Gjirokastrë “Mbi miratimin e Lejeve të Ndërtimi”.
- 5.Vendim Nr.88 datë 01.11.2004 i Komunës Petran “Mbi miratimin e tarifave për pagesën e truallit”.
- 6.Vendim Nr.49 datë 09.07.2004 i Këshillit të Komunës Petran “Për dhënie shesh ndërtimi”.
7. Formular Nr.2, Vendimi Nr.49 datë 09.07.2004 i Këshillit të Komunës Petran “Për dhënie Shesh Ndërtimi”.
8. Vendim Nr.49 datë 09.07.2004 “Për dhënie Shesh Ndërtimi”.
9. Planimetri e sheshit të ndërtimit të objektit banesë.
- 10.Mandat arkëtim datë 21.06.2005 në vlerën 175 000 lekë.
- 11.Planimetri e Sheshit të Ndërtimit miratuar nga Kryetari i Komunës Petran.
12. Planëvendosje aktuale e truallit të z.Ylli Makollari nga topograf i licensuar A.Bakushi.



2. Z.Kastriot STERJO

1. Kërkesa e z.Kastriot Sterjo, Nr 76 Prot, datë 12.01.2026.
2. Fotokopje pasaportës .
3. Shkresa Nr.669 prot. datë 17.05.2025 nga Seksioni Urbanistikës, Bashkia Përmet.
4. Vendim i K.RR.T Nr.3 datë 17.03.2005 "Për Miratimin e Destinacionit të Sheshit të Ndërtimit dhe Kondicioneve Urbane të tij".
5. Leje Ndërtimi Nr.3 datë 17.03.2005, me objekt shtesë banesë 1kt me bodrum dhe shesh funksional.
6. Vendim Nr.3 datë 17.03.2005 i K.RR.T Bashkia Përmet për miratimin e shesh leje ndërtimi për objektin.
7. Mandat Arkëtimi datë 17.05.2005 në shumën 75 552 lekë.
8. Mandat Arkëtimi Nr.356 datë 14.04.2005 në shumën 19 937 lekë.
9. Hartë treguese provizore.
10. Preventiv punimesh, objekti : shesh funksional.
11. Kërkesë për miratimin e destinacionit dhe kondicioneve urbane të sheshit të ndërtimt.
12. Kërkesë për miratimin e lejes së ndërtimit të objektit.
13. Lidhja e objektit me infrastrukturën inxhinierike.
14. Planimetria e miratuar e sheshit për ndërtimin e objektit.
15. Studimi Urbanistik pjesor për sheshin funksional.
16. Studimi Urbanistik për ndërtimin e objektit.

Në bazë të sa më sipër, i propozohet Këshillit Bashkiak Përmet miratimi i vendimit:

"Për Përfundimin e Procedurave lidhur me VKM-në Nr. 329, Datë 22.5.2019, "Për Përcaktimin e Rregullave të Bashkërendimit të Punës së Bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Për Regjistrimin e Trojeve të Dhëna për Ndërtim nga Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe Për Rregullimin e Marrëdhënieve Juridike të Pronësisë Mbi Këto Troje, Për Efekt Regjistrimi" dhe për Lidhjen e Kontratave para Noterit për 2(Dy) Familje".

Konceptoi : K.Lilo

P.Mara

Pranoi : E.Kushe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ Prot

Përmet më. ____/____/2026

P/VENDIM

**PER PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË NGA FONDI 6% DHE
FONDI I BASHKISË**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, të ligjit nr.57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr.79/2023, datë 12.10.2023 të vendimit nr.597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike" të ndryshuar.

Familjet do të përzgjidhen në bazë të kriterëve të miratuara nga Këshilli Bashkiak dhe masa e pagesës do të llogaritet në bazë të Udhëzimit Nr. 4 datë 17.02.2017.

Kriteret e përcaktuara për familjet në nevojë dhe që do të trajtohen nga fondi 6% dhe nga fondet e akorduara nga Bashkia.

1. Familje me një prind me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë.
2. Persona të vetmuar në moshë para pensionit dhe s'kanë të ardhura të tjera.
3. Familje me më shumë se një fëmijë të lindur njëherësh (binjakë, trinjakë, katërnjakë) dhe pa të ardhura financiare.
4. Familje të divorcuara të cilat janë me urdhër mbrojtje nga gjykata.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

KRYETARI BASHKISË

Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot.

Përmet më _____.2026

P/VENDIM

Për miratimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmës ekonomike, deri në 6% .

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligji nr.9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmen dhe shërbimet shoqerore " i ndryshuar me VKM nr.868 dt.29.12.2021 "Per disa ndryshime ne Vendimin 597 dt.04.09.2019 të K.M."Për percaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe mases mujore te perfitimit te ndihmës ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese,mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike,VKM nr.85 dt.10.02.2021,nr.617,date 22.09.2022 i perditesuar: Vendimin e Keshillit Bashkiak Permet me fondet e Buxhetit Vendor.VKB nr.107 date 18.12.2024 "Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2025 dhe percaktimin e numrit te punojseve të bashkise, institucioneve në varesi të saj". Keshilli Bashkiak,me propozim të Kryetares së Bashkisë:

VENDOSI

1.Të përfitojnë ndihmë ekonomike për Muajn Dhjetor 2025, 6 familje me një fond prej 21.184 lekë.

2. Familjet që përfitojnë janë si më poshtë:

Nr	Emri, Atësia, Mbiemri	Bashkeshortja/i	N.ant.	Shuma
1	Ylli Guçe Pelushaj	Zylkade Qerim Pelushaj	2	3.703
2	Roland Petraq Jorgji	Divorcuar	1	2.178
3	Lame Enver Ferati	Silvana Kujtim Ferati	3	5.227
4	Mimoza Skënder Gjoka	Divorcuar	1	2.178
5	Lefteri Mihal Tyto	Divorcuar	1	5.720
6	Flavia Musa Pelushaj	Beqare	1	2.178
	SHUMA			21.184

3..Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi sektori buxhet-finance dhe zyra e ndihmës ekonomike.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikes 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen Vendore", (i ndryshuar).

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot.

Përmet më _____, 2026

RELACION

**PËR MIRATIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËS
EKONOMIKE, DERI NË 6% .**

Mbështetur në Ligjin Nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji Nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" Ligji 935 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar me VKM Nr.955 datë 07.12.2016 (kreu II pika 13) dhe udhëzimi nr.5 datë 17.02.2017 pika 2 i Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. Për përcaktimin kritereve, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike si dhe VKM nr.85 datë 10.02.2021, nr.868, datë 29.12.2021; nr.617, datë 22.09.2022 i përditësuar Vendimi i Këshillit Bashkiak Përmet me fonde të Buxhetit Vendor Nr.107 datë 18.02.2024 "Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë për vitin 2025 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, institucioneve në varësi të saj "Këshilli Bashkiak ka të drejtë të trajtojë me ndihmë ekonomike familjet aplikuese që nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, deri 6% të bllok ndihmës ekonomike të muajit. Dhjetor 2025 me Vendim të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Gjirokastrë. Nr.10/2022 datë 27/10/2022 për dhënien e NE për periudhën 01-31-2025 Për Bashkinë Përmet. (Sipas vendimit të Muajit Dhjetor 2025).

Për sa më sipër vlera e fondit të kushtëzuar (bllok ndihma ekonomike) për Muajin Dhjetor 2025

është 47 familje me, Shumën prej 366.037 lekë dhe për tu trajtuar familje me ndihmë ekonomike janë në dispozicion 6% e këtij fondi ose 21.962 lekë, për Muajin Dhjetor 2025.

Mbështetur në të dhënat për dhënien e Ndihmës Ekonomike për periudhën 1-31 Dhjetor 2025 kanë aplikuar 4 familje asedhenjë familje nuk ka dale fituese 47 janë përfituese në skemën e Ndihmës Ekonomike.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i aplikuesve që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme për periudhën 01 Dhjetor deri më datën 31 nga vlerësimi I SH.S.SH rekomandojmë:

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar prej 6%, 6 familje me një vlerë 21.184 lekë, nga ku fondi 6% në total sipas vendimit është në Shumën 21.962 diferencë prej 778 lekë do të mbetet e papërdorur për muajin Dhjetor.

Specialisti i NE

Jurigen SIMONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot.

Përmet më _____.2026

P/VENDIM

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË MUAJI
JANAR 2026**

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligji nr.9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar, VKM nr.869 datë 29.12.2021 për disa ndryshime në VKM nr.597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, VKM Nr 868 datë 29.12.2021 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike", VKM Nr617 datë 22.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597, datë 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore, të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike". VKB nr.107 datë 18.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të bashkise për vitin 2025 dhe përcaktimin e numrit të punojseve të bashkise, institucioneve në varesi të saj" Këshilli Bashkiak me propozim të Kryetarit të Bashkise:

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihme ekonomike për Muajin JANAR 2026, 33 familje me një fond **123.500 lekë**.

2. Fondet të përballohen nga struktura :

1.Gr.00.Tit.AC135.Kap.01.Art.606.Kod produkti V043AAD per shumen 123.500 lekë

3. Familjet që përfitojnë janë si më poshtë:

Nr	Emri, Atesia, Mbiemri	Bashkeshortja/i	N.ant.	Shuma/leke
1	Ziso Apostol Kristo	Valentina Polikron Kristo	3	4200
2	Xhilda Xhemal Selimllari	Xhilda Xhemal Selimllari	2	3600
3	Mitro Gani Zeqiri	Lefteri Rrapi Zeqiri	4	4700
4	Syrja Mehmet Hoxha	Beqar	1	3200
5	Drita Irakli Kosta	Divorcuar	2	3600
6	Lefteri Polikron Proko	E ve	1	3200
7	Andon Dhimitraq Kukureci	I ve	2	3600
8	Aferdita Nuredin Lahe	Beqare	1	3200
9	Arben Thoma Teka	Mirela Xheli Teka	6	5400
10	Viktor Josif Proko	Divorcuar	1	3200
11	Dhimo Naun Dimçi	Lindita Hysen Dimçi	3	4200
12	Vera Thanas Naqe	E ve	2	3600
13	Leonart Petro Markaj	Kristina Petraq Markaj	3	4200

15	Thoma Aristidh Ilia	Maria Nuredin Ilia	4	4700
16	Xhensila Maksim Jahhaj	Beqare me Femijë	2	3600
17	Violeta Guce Pelushi	Beqare	1	3200
18	Engjellushe Manxho Canollari	E ve	1	3200
19	Rivelino Fatmir Doko	Hurma Leonidha Doko	4	4700
20	Bajame Fari Hysenshahaj	E ve	1	3200
21	Lida Koco Thomollari	Divorcuar	1	3200
22	Vasilika Bedri Malka	E ve	2	3600
23	Ilir Sali Jashari	Beqar	1	3200
24	Vitori Llazo Caci	Beqare	2	3600
25	Luam Ferit Zeneli	Gezime Tafil Zeneli	4	4700
26	Ilber Kudret Dalipaj	Divorcuar	1	3200
27	Kastriot Kristo Koto	Kastriot Kristo Koto	3	4200
28	Kastriot Astrit Male	Divorcuar	1	3200
29	Vangjush Thanas Mamillo	Gentiana Seit Mamillo	3	4200
30	Bari Avni Zaimi	Valbona Zenel Zaimi	2	3600
31	Kadri Petrit Maska	Beqar	1	3200
32	Dashnor Guçe Pelushaj	Vezire Ali Pelushaj	4	4700
33	Klodiana Kristofor Peçi	Divorcuar	1	3200
34	Lulëzim Barjam Beqari	Divorcuar	1	3200
	SHUMA			123.500

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhet-Finances dhe Tatim –Taksa/Spektori i Buxhet Financës.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6,të nenit 55,të ligjit nr.139/2015,"Për vetqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA

Alma Hoxha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot.

Përmet më _____._____.2026

RELACION

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË MUAJI
JANAR 2026**

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë.20.06.2019 ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligji nr.9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar, VKM nr.869 datë 29.12.2021 për disa ndryshime në VKM nr.597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, VKM Nr 868 datë 29.12.2021 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike", VKM Nr.617 datë 22.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597, datë 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave," Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore, të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike". VKB nr.107 datë 18.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2025 dhe përcaktimin e numrit të punojësve të bashkisë, institucioneve në varësi të saj. Familje të cilat janë përfituese në fondin e bashkisë janë ato familje të cilat mbasi kanë bërë aplikimin në Sistemin e Ndihmës ekonomike, rekomandimin në fondin 6% nuk janë fituese. Dhe nga vizitat e kryera në familje nga Administratorët shoqëror duke parë gjëndjen ekonomike të këtyre familjeve të cilat janë në gjëndje të dobët ekonomike u arsyetua që të përfshihen në fondin e familjeve në nevojë.

Përsa më sipër rekomandojmë të ndihmohen për muajin Janar 33 familje me një vlerë prej 123.500 lekë.

Specialisti i NE

Jurigen SIMONI



Sheshi "Abdyl Frashëri"; tel. +35581322254

e-mail: info@bashkiapermet.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISE



BASHKIA PËRMET



VODAFONE ALBANIA SH.A

Nr. _____ Prot. Datë _____, 2026

Nr. _____ Prot. Datë _____, 2026

**KONTRATË QIRAJE PËR
DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR/KULLOSOR PUBLIK**

Në Përmet sot më datë _____, 2026, në zbatim Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i nryshuar, të Ligjit Nr.57/2020 "Për Pyjet", të ndryshuar, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar, si dhe të nenit 801 e ne vijim të ligjit Nr. 7850 date 29.07.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", VKM Nr.433 datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kulotave publike", e ndryshuar si dhe Udhëzimit të Ministrit nr.1, datë 09.03.2016, "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.107 datë 04.12.2025 *"Për miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes totale prej 0.1843 ha per ndërtimin e antenës së lëvizshme dhe ndërtime te tjera ndihmëse nga shoqeria Vodafone Albania Sh.a, njësia Administrative Piskovë, Bashkia Permet "*, dhe vazhdimin e procedurave për lidhjen e Kontratës midis Bashkisë Përmet e shoqërisë Vodafone Albania sha. , i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastr me shkresën nr. 1047/1 Prot, datë 22.12.2025, dhënie me kontratë qiraje të pasurisë Nr.257, ZK 3153 që i përket ngastrës pyjore Nr.27 të Ekonomisë Kullosore " **Dhëmbel**", Njësia Administrative Piskove, sipërfaqe totale prej **0.1843 ha e ndarë në 100 m2 për ndërtimin e stacionit Vodafone_1499 PISKOVË , 81 ml për hapjen e rrugës së re ndihmëse si dhe 500 ml për implementimin e linjës elektrike TM të nevojshme, njësia Administrative Piskovë, Bashkia Permet**, për një afat 9 (nëntë) vjeçar", lidhet kjo kontrate qiraje midis:

I. PALËT :

1. **Bashkia Përmet**, (këtu e më poshtë referuar si "Qiradhënësi"), e përfaqësuar nga Kryetari Znj.Alma Hoxha Person juridik, me NIPT Numër K49719214P.
2. **Vodafone Albania Sh.A.** (këtu e më poshtë referuar si "Vodafone Albania" ose "Qiramarrësi"), e regjistruar me Vendim Gjykatë Nr. 25766, datë 10 Maj 2001 me seli në Autostrada Tiranë – Durrës, Rr. "Pavaresia", Nr. 61, Kashar, Tiranë, Shqipëri, me NIPT K11715005L, përfaqësuar ligjërisht nga Administratori **Z. Balazs REVESZ** me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

II. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Duke qenë se ekzistojnë kushtet paraprake, të cilat përbëjnë pjesë integrale të kësaj kontrate, palët bien dakord si vijon:

a. Kushtet Paraprake dhe Shtojcat

Kushtet Paraprake ashtu si dhe Shtojcat përbëjnë pjesë integrale të saj.

b. Përcaktime

- A. **Vendi në të cilën do të instalohet Stacioni Bazë i Transmetimi (BTS)**, që do të përbëhet kryesisht, por jo vetëm, nga një kontenier për BTS, një Kullë të antenave, një Gjenerator si dhe çdo pajisje apo material tjetër të nevojshëm për funksionimin e stacionit do të jetë pasuria Nr. 257, Zona Kadastrale 3153, fshati Rapckë, që i përket ngastrës pyjorë/kullosore Nr.27, të ekonomisë kullosore "Dhëmbel", Njësia administrative Piskove, me sip. 100 m², për veprimtarinë "Për vendosje antene të telefonisë fikse, të lëvizëshme, televizive, radio – komunikimit". Ky stacion do të ndërtohet konform akteve ligjore për zhvillimin dhe kontrollin e territorit nga Vodafone Albania për qëllimin e ushtrimit të aktivitetit të saj.
- B. **Rrugë Kalimi/E Drejta e Kalimit:** Rruga për në BTS përfshin kalimin nga rruga kryesore deri te Antena, të cilat përbëjnë pjesë të pronës së zotëruar nga Qiradhënësi, e cila do ti shërbejë Vodafone Albania për të hyrë në stacionin e BTS e ndërtuar prej saj.
- C. **Ndërtim linje elektrike Tension i Mesëm:** Pajisjet që do të realizojnë lidhjen për furnizimin me energji elektrike duhet të jenë të reja dhe parametrat nominalë të tyre (përcjellesat, kabllot, transformatori, çelat e Tensionit të Mesëm (TM), panelet e Tensionit të Ulët (TU), matësi i konsumit të energjisë elektrike, etj.) duhet të jenë në përputhje me tipin dhe kërkesat teknike të përshkruara sipas standardeve të kërkuara nga: a) Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sha) b) Dispozitat shtetërore në fuqi c) Standardet ndërkombëtare IEC 5. Tokëzimi i kabinës së transformatorit apo i pikës së lidhjes në TU të jetë konform legjislacionit në fuqi dhe rezistenca ohmike e saj të jetë konform rregullave të sigurimit teknik, më e vogël se $< 4\Omega$.

Neni 1

Objekti i kontratës

1. "Qiradhënësi" i jep me qira për përdorim Qiramarrësit sipërfaqen sipërfaqe totale prej **0.1843 ha e ndarë në 100 m² për ndërtimin e stacionit Vodafone 1499 PISKOVË**, 81 ml për hapjen e rrugës së re ndihmëse si dhe 500 ml për implementimin e linjës elektrike TM të nevojshme, njësia Administrative Piskovë, Bashkia Permet, e cila është pjesë e fondit pyjor/kullosor publik, ekonomia pyjorë/kullosore "Dhëmbel", pasuria nr.257, Zona Kadastrale 3153, fshati Rapckë, kategoria "kullotë", Njësia Administrative Piskovë, në administrim të Bashkisë Permet për ushtrimin e veprimtarisë "Për vendosje antene të telefonisë fikse, të lëvizëshme, televizive, radio-komunikimit".

Neni 2

Qëllimi

Kjo kontratë ka për objekt dhënien në përdorim kundrejt pagimit të cmimit të qirasë, të sipërfaqes së përcaktuar në nenin 1 të saj, për ushtrimin e veprimtarisë "Për vendosje antene të telefonisë fikse, të lëvizëshme, televizive, radio-komunikimit", vetëm sipas qëllimit dhe sipërfaqes të miratuar nga Këshilli i Bashkisë Permet për ushtrimin e veprimtarisë dhe kërkesave të përcaktuara në



kontratë si dhe në Lejet përkatëse që do të duhet të merren nga Qiramarrësi përpara fillimit të ndërtimit të stacionit.

Krahas sipërfaqes si më sipër qiradhënësi i jep qiramarrësit të drejtën e kalimit në pronën e qiradhënësit për në objekt (BTS). Këto të drejta i jepen qiramarrësit në mënyrë të pandryshueshme, të pa kushtëzuar dhe për të gjithë kohëzgjatjen e kësaj kontrate, me qëllim që të bëjë të mundshëm kalimin për në objekt dhe shfrytëzimin e pasurisë së paluajtshme në pronësi të qiradhënësit, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj kontrate.

Neni 3 Afati i kontratës

- 3.1 Kontrata e lidhur sot më datë _____.2026, me afat deri më datë _____.2035. Kontrata e Qirasë lidhet për një afat 9 (nëntë) vjeçar, duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët, me të drejtë rinovimi në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi. Efektet ligjore dhe financiare do të fillojnë me firmosjen e kësaj kontrate nga palët.
- 3.2 Tre (3) muaj përpara përfundimit të afatit të mësipërm, secila palë duhet të njoftojë palën tjetër për të negociuar shtyrjen e afatit të kontratës ose për përfundimin e saj.
- 3.2 Në mungesë të këtij njoftimi ose të ndonjë komunikimi midis palëve, kontrata do të konsiderohet e zgjidhur në përfundim të afatit të përcaktuar në këtë kontratë.

Neni 4 Vlera e qirasë vjetore

4.1 Vlera e Qirasë vjetore për sipërfaqen e fondit pyjor të dhënë me qera prej 100 m² (0.01 ha), ku është vendosur stacioni është 80,000 (tetëdhjetë mijë) lekë bruto, Ekonomia Kullimore "Dhëmbel", ngastra Nr.27 (0.01ha x 8.000.000), e llogaritur sipas VKM-së nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore" e ndryshuar, shtojca 1, pika 7;

Rruga për në BTS e cila përfshin nga rruga kryesore deri tek antena, të cilat përbëjnë pjesë të pronës së zotëruar nga qiradhënësi 81 ml (tetëdhjetë e një) e llogaritur 2,835 (dy mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) lekë bruto, Ekonomia Kullimore, ngastra nr.27 (0.081km x 35.000 lekë/ha/vit) e llogaritur sipas VKM-së nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore" e ndryshuar, shtojca 1, pika 11;

Ndërtim linje elektrike Tension i Mes Ekonomia Kullimore, ngastra nr.27 500 ml (pesëqind ml) e llogaritur 72,500 (shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë bruto, Ekonomia Kullimore, ngastra nr.27 (0.5 km x 145,000 lekë/ha/vit) e llogaritur sipas VKM-së nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore" e ndryshuar, shtojca 1, pika 10.

Qiraja do të paguhet paradhënie çdo vit. Shuma e qirasë do të qëndrojë e pandryshuar për të gjithë kohëzgjatjen e kësaj kontrate dhe nuk do të ndryshojë pa miratimin me shkrim të palëve. Totali i qirasë do të jetë 155 335 (njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë bruto.



4.2 Çmimi i parashikuar më sipër është çmimi i vetëm që do të paguhet nga Vodafone, për gjithë objektin/qëllimin e (sipas përcaktimit të Kapitullit II, pikës "b-përcaktime" të kësaj kontrate, duke përfshirë të gjitha taksat dhe tatimet e aplikueshme, nëse ka të tilla. Pagesa e qirasë do të bëhet çdo vit sipas kushteve të kësaj kontrate.

4.3 Qiraja do t'i paguhet qiradhënësit në llogarinë bankare si më poshtë, e cila do të kryhet brenda 21 ditëve pune, nga data e dorëzimit të faturës të fiskalizuar përkatëse ose në çdo llogari tjetër bankare për të cilën qiradhënësi do të njoftojë me shkrim Vodafone Albania.

Emri i Përfutuesit: Bashkia Përmet

Dega e Thesarit : Përmet

Kodi i Thesarit : 1128

- 4.4 Qiradhënësi ka të drejtë që brenda dhjetë (10) ditëve nga nënshkrimi i procesverbalit të fillimit të punimeve për ndërtimin e stacionit të lëshojë faturën përkatëse për akëtim. Pagesa nga qiramarrësi do të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të faturës përkatëse të fiskalizuar.
- 4.5 Çdo pagesë tjetër e përvitshme do të kryhet brenda 30 ditëve nga dorëzimi i faturës përkatëse të fiskalizuar, e cila në çdo rast do të lëshohet brenda 10 ditësh nga fillimi i periudhës përkatëse 1(një) vjecare.
- 4.6 Vlera e qirasë përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës do të jetë e pandryshueshme. Ajo do të ndryshojë vetëm nëse do të ketë ndryshime të akteve nënligjore të cilat përcaktojnë vlerat e saj.
- 4.7 Në rast mosmarrëveshje me qiradhënësin ose me palë të treta që kanë pretendime për pronësinë apo të drejta reale mbi pronën/sipërfaqen e marrë me qira, qiramarrësi do të pezullojë pagesën e qirasë deri në zgjidhjen përfundimtare të konfliktit të pronësisë midis palëve. Kryerja e pagesës së qirasë për periudhën e pezulluar do të bëhet për llogari të palës që i është njohur e drejta e pronësisë bazuar në vendimin e formës së prerë të gjykatës.
- 4.8 Në rast se qiramarrësi nuk do të kryejë pagesën sipas kushteve të vendosura sa më sipër, Qiradhënësi i lind e drejta të kërkojë një kamatë vonesë prej 0.01% për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 10 % e vlerës totale të vlerës së pagesës përkatëse. Për efekt të llogaritjes së kamatëvonesave do të konsiderohet kalimi i afatit të përcaktuar për pagesën sipas nenit 4.4, 4.5 më sipër.

Neni 5

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRADHËNËSIT

- 5.1 Qiradhënësi merr përsipër dhe i krijon qiramarrësit mundësinë që ta gëzojë dhe ta përdorë atë qetësisht ndaj pretendimeve të pabazuara ligjërisht të ngritura nga të tretët.
- 5.2 Qiradhënësi garanton që në pronën objekt i kësaj kontrate, nuk rëndon asnjë barrë apo detyrim, ose e drejtë reale ose personale që të çënojnë gëzimin, si dhe asnjë detyrim që rrjedh nga sekuestrimi.
- 5.3 Qiradhënësi nuk përgjigjet për pretendime të tjera që, nuk kanë të bëjnë me sipërfaqen e dhënë në përdorim, me objektin dhe qëllimin e kontratës.
- 5.4 Qiradhënësi angazhohet për të zgjidhur çdo lloj mosmarrëveshje që do të lind si pasojë e pretendimeve të të tretëve mbi pronën dhe për ta mbajtur Vodafone Albania të padëmtuar nga ndonjë pretendim i të tretëve si më sipër.

5.5 Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të kontratës kur qiramarrësi nuk ka shlyer vlerën e qirasë sipas përcaktimeve të nenit të kësaj kontrate, dëmton ose nuk mirëmban/e përmirëson sipërfaqen e marrë në përdorim, nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga kontrata, ato të përcaktuara në kushtet e Lejeve përkatëse të lëshuara nga autoritetet shtetërore për ushtrimin e aktivitetit të vet si dhe nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë në fushën e mjedisit, pyjeve dhe kullotave.

5.6 Qiradhënësi ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e "Qiramarrësit".

5.7 Qiradhënësi ka të drejtë që, në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së kontratës, nëpërmjet njësisë monitoruese të kontratës së qirasë, të monitorojë kontratën për verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në të.

Neni 6

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRËSIT

6.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, "Qiramarrësi" ka të drejtë që për të punësuarit e saj, agjentët, përfaqësuesit dhe çdo person tjetër që subjekti konsideron të përshtatshëm, të ketë të drejtë të hyjë lirisht në sipërfaqen e dhënë në përdorim objekt të kësaj kontrate; të kryejë çdo veprim të cilin mund ta konsiderojë të nevojshëm ose të dobishëm gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij në zbatim të kushteve dhe qëllimit të përcaktuara në dispozitat e kësaj kontrate; të transportojë persona, mallra, pajisje dhe materiale të tjera brenda sipërfaqes të marrë me qira.

6.2 "Qiramarrësi", nuk mund të transferojë të drejtën e siguruar nga kjo kontratë për përdorimin e sipërfaqes së marrë në përdorim, të tretëve, pa marrë më parë miratimin nga "Qiradhënësi" për ushtrimin e veprimtarisë.

6.3 Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë me nën qira dhe të lidhë nën kontraktime me subjekte të tjerë apo, t'ia kalojë kontratën e lidhur një subjekti tjetër.

6.4 Qiramarrësi, do të kryejë me shpenzimet e veta, çdo punim mirëmbajtjeje që do t'i konsiderojë të nevojshme në sipërfaqen e marrë në përdorim dhe në Rrugën e Kalimit.

6.5 Qiramarrësi do të përdorë sipërfaqen e marrë në përdorim dhe rrugën e kalimit me qëllim për të ushtruar aktivitetin që përcaktohet në nenet 1 dhe 2 të kësaj kontrate.

6.6 Qiramarrësi të mbrojë dhe mirëadministrojë sipërfaqen pyjore/kullosore në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.57/2020 "Për Pyjet", të ndryshuar, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar.

6.7 Qiramarrësi të lejojë dhe të shoqërojë punonjësit e Shërbimit Pyjor të ushtrorin kontrollë për zbatueshmërinë e kërkesave të përcaktuara në kontratë për sipërfaqen e fondit pyjor/ kullosor të dhënë në përdorim.

6.8 Qiramarrësi detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padënmtuar.

6.9 Qiramarrësi, në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa e demtuar atë.

6.10 "Qiramarrësi" në asnjë rast nuk mund ta rëndojë me barrë, pronën objekt kontrate.

6.11 Qiramarrësi detyrohet të zbatojë çdo dispozitë ligjore që del e re ose ndryshim që u bëhet atyre ekzistuese për pyjet, kullotat dhe gjuetinë.

Neni 7 DETYRIME TË PËRBASHKETA TË PALËVE

7.1 Qiradhënësi siguron Qiramarrësin se kjo Kontratë, kushtet dhe afatet e saj do të jenë të pandryshueshme dhe kontrata në tërësinë e saj do të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e vlefshmërisë së saj kundrejt palëve të treta, të cilave mund t'u kalojë titulli i pronësisë gjatë afatit të kësaj Kontrate.

7.2 Në fund të periudhës së kësaj kontrate ose në përfundim të saj, qiramarrësi do të rehabilitojë sipërfaqen për çdo dëmtim që mund të jetë shkaktuar gjatë veprimtarisë, dhe do ta dorëzojë sipërfaqen e marrë, siç ishte në gjendjen fillestare, përveç konsumimit fizik normal.

7.3 Të gjitha njoftimet dhe komunikimet midis palëve do të bëhen me shkrim ne adresat:

Për Qiradhënësin: Bashkia Përmet

Për Qiramarrësin: Vodafone Albania Sh.A. Autostrada Tiranë – Durrës, Rr. "Pavaresia", Nr. 61, Kashar, Tiranë, Shqipëri.

7.4 Palët do të veprojnë në përputhje me ligjin e zbatueshëm në lidhje me këtë marrëveshje. Secila nga palët ka detyrimin të njoftojë tjetrën në rast shkeljeje të ligjit në fjalë apo në rast të një ndryshimi në sanksionet dhe kontrollet Tregtare. Në këtë rast, secila nga palët ka të drejtë të pezullojë ofrimin e shërbimeve apo të përfundojë marrëveshjen me efekt të menjëhershëm dhe pa pasoja.

Neni 8 FORCA MADHORE

8.1 Qiradhënësi çlirohet nga përgjegjësia për mospërbushjen, pjesërisht apo tërësisht, të detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontrate nëse vërtetohen rastet e forcës madhore. Konsiderohet forcë madhore: lufta, e shpallur ose jo, kryengritje, greva, fatkeqësi natyrore, zbatimi i planeve të urgjencës kombëtare ose lokale si dhe kufizime të tjera të vendosura me ligj, fatkeqësi natyrore si ciklone, tërmete, shpërthime zjarri dhe përmytje.

8.2 Në rastet e forcës madhore, Palët me mirëkuptim dhe me miratim të përbashkët, mund të caktojnë një afat tjetër të arsyeshëm për ekzekutimin e mëtejshëm të detyrimeve të parashikuara në këtë kontratë.

8.3 Nuk do të konsiderohen forca madhore, mospërbushja e detyrimeve që kanë ardhur si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve jo korrekte të Qiradhënësit me shtetin, personat fizikë ose juridikë.



Neni 9 ZGJIDHJA E KONTRATËS

- 9.1 Kontrata zgjidhet me marrëveshje midis palëve si dhe me mbarimin e afatit të saj.
- 9.2 Qiradhënësi mund të zgjidhë këtë kontratë përpara afatit të parashikuar në të vetëm nëse qiramarrësi nuk respekton kushtet e lejes mjedisore dhe qiramarrësi nuk i paguan qiranë e parashikuar brenda afatit të përcaktuar dhe nëse shuma e kamatëvonesave të pagueshme, bëhet më e lartë se 30% e qirasë së papaguar dhe Vodafone Albania vazhdon të mos shlyejë detyrimet.
- Në këtë rast qiradhënësi duhet të njoftojë me shkrim Vodafone Albania që të përmbushë detyrimet e saj brenda një afati prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data që Vodafone Albania do të marrë këtë njoftim. Në rast se Vodafone Albania nuk i shlyen detyrimet e saj edhe pas kalimit të këtij afati, kontrata do të konsiderohet e zgjidhur.
- 9.3 Kontrata zgjidhet automatikisht kur sipërfaqja e dhënë në përdorim kërkohet për interesa publike të miratuara nga insitucionet përkatëse.
- 9.4 Kjo kontratë zgjidhet në mënyrë të njëanshme kur subjekti për sipërfaqen që ka kryer veprimtarinë, nuk e ka rehabilituar në zbatim të planit të rehabilitimit të miratuar.

DISPOZITA TË FUNDIT

Për çështjet që nuk trajtohen në kontratën e mësipërme do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil që trajtojnë kontratën e qirasë.

Mosmarrëveshjet gjatë zbatimit të kësaj kontrate, zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet palëve; në të kundërt në Gjykatën kompetente.

Çdo korrigjim i kontratës, para dhe pas nënshkrimit të saj, e bën atë të pavlefshme.

Pjesë integrale e kësaj kontrate do të jenë : VKB-të , Raporti Tekniko-Ekonomik,VNM, Leje Mjedisore, Leje Ndërtimi dhe dokumenta të tjera shtesë të miratuara nga palët, që formojnë pjesë përbërëse dhe të pandashme të kësaj kontrate.

Kjo kontratë qiraje u formulua në katër kopje origjinale në gjuhën Shqipe, nga të cilat një e merr qiramarrësi dhe tre i merr qiradhënësi.

P A L Ë T:

QIRADHËNËSI
BASHKIA PERMET
KRYETAR
Alma HOXHA

QIRAMARRËSI
VODAFONE ALBANIA SH.A
ADMINISTRATOR
Balazs REVESZ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

NR. _____, DATË. ____ . ____ / 2025

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT KULTUROR DHE ARGËTUES PËR VITIN 2026
DHE AKORDIMIN E FONDIT PËRKATËS**

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e këshillave artistiko-kulturor dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre”, të ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 24.05.2005 të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko-kulturor”, si dhe bazuar në relacionin e Drejtorisë së Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

KËSHILLI BASHKIAK I BASHKISË PËRMET

VENDOSI:

1. Të miratojë programin kulturor dhe artistik për vitin 2026, si më poshtë:

- Festa e 7–8 Marsit – 130,000 lekë
- Dita e Verës (14 Mars) – 170,000 lekë
- Në Gjurmët Naimiane – 100,000 lekë
- Festojnë Fëmijët (1 Qershor) – 80,000 lekë
- Të Premtet Muzikore (Korrik) – 120,000 lekë
- Muaji i Letërsisë dhe Artit – 20,000 lekë
- Festojmë së Bashku Festat e Fundvitit – 100,000 lekë

Sheshi “Abdyl Frashëri”/tel.+35581322254/web:www.bashkiapermet.gov.al/e-mail:info@bashkiapermet.gov.al



2. Të miratojë kryetjen e shpenzimeve për realizimin e aktiviteteve të mësipërme në vlerën totale 720,000 (shtatëqind e njëzet mijë) lekë, që do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Përmet për vitin 2026.

3. Ngarkohet Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PËRMET

RELACION

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT KULTUROR DHE ARGËTUES PËR VITIN 2026 DHE AKORDIMIN E FONDIT PËRKATËS

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Vendimin nr. 540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e këshillave artistiko-kulturor dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre", të ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 24.05.2005 të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko-kulturor", si dhe bazuar në relacionin e Drejtorisë së Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, paraqitet për miratim programi kulturor dhe argëtues për vitin 2026.

Në funksion të promovimit të vlerave kulturore, sociale dhe edukative në komunitet, Bashkia Përmet ka hartuar një program vjetor aktiviteteve kulturore dhe artistike, i cili synon të gjallërojë jetën kulturore të qytetit dhe zonave përreth, të përfshijë qytetarë të të gjitha grupmoshave dhe të kontribuojë në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore e shpirtërore përmetare.

Për hartimin e programit kulturor për vitin 2026, është mbledhur Këshilli Artistik i Bashkisë Përmet, i miratuar me VKB nr. 86, datë 05.11.2024, i cili, në përputhje me kompetencat e tij ligjore dhe statutore, ka shqyrtuar projekt-propozimet e paraqitura nga Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Në mbledhjen e datës 13.01. 2026 me vendim nr 1.. Këshilli Artistik ka analizuar nevojat kulturore të komunitetit, kalendarin festiv kombëtar dhe lokal, si dhe përvojën e viteve të mëparshme, duke marrë vendim për programin e aktiviteteve kulturore që do të zhvillohen gjatë vitit 2026, së bashku me fondet përkatëse për realizimin e tyre.

Programi i propozuar përfshin aktivitete me karakter festiv, artistik, edukativ dhe letrar, të shpërndara gjatë gjithë vitit, të cilat synojnë:

- forcimin e identitetit kulturor lokal,
- përfshirjen aktive të fëmijëve, të rinjve dhe komunitetit,
- promovimin e trashëgimisë kulturore dhe figurave të rëndësishme të historisë dhe letërsisë shqiptare,
- krijimin e një kalendari kulturor të qëndrueshëm dhe të mirëorganizuar për qytetin e Përmetit.

Këshilli Artistik ka dhënë dakordësinë për realizimin e projekteve të paraqitura dhe ka rekomanduar miratimin e tyre nga Këshilli Bashkiak.

Duke qenë se programi kulturor për vitin 2026 është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi;

Këshilli Artistik i Bashkisë Përmet është mbledhur dhe ka miratuar programin e propozuar të aktiviteteve;

aktivitetet e planifikuara kanë impakt të drejtpërdrejtë kulturor, social dhe edukativ në komunitet;

fondet e kërkuara janë të arsyetuara dhe të përballueshme nga buxheti i Bashkisë Përmet;

Rekomandohet:

Këshilli Bashkiak i Bashkisë Përmet të miratojë programin kulturor dhe artistik për vitin 2026, si dhe fondin përkatës për realizimin e tij, sipas projekteve dhe vlerave financiare të paraqitura në këtë relacion.

PËRSHKRIMI I PROJEKTEVE

(Projektet e përshkruara më poshtë janë shqyrtuar dhe miratuar nga Këshilli Artistik)

Aktivitetet	Vlera
Festa e 7-8 Marsit	130,000 lekë
Dita e Verës (14 Mars)	170,000 lekë
Në Gjurmët Naimiane	100,000 lekë

Sheshi "Abdyl Frashëri"/tel.+35581322254/web:www.bashkiapermet.gov.al/e-mail:info@bashkiapermet.gov.al



Festojnë Fëmijët (1 Qershor)	80,000 lekë
Të Premtet Muzikore (Korrik)	120,000 lekë
Muaji i Letërsisë dhe Artit	20,000 lekë
Festojmë së Bashku Festat e Fundvitit	100,000 lekë
Totali	720,000 (shtatëqind e njëzet mijë) lekë.

Konceptoi:

Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Arjana PAPAPANO



VENDIM I KESHILLIT ARTISTIK TE BASHKISE PERMET

Nr 1
Data 13.01.2026

Këshilli Artistik pranë Bashkisë Përmet, pasi mori në shqyrtim projekt- propozimet e paraqitura si më poshtë;

- 1- Festat e 7- 8 Marsit
- 2- Dita e verës
- 3- Në gjurmët naimjane
- 4- Festojne fëmijët
- 5- Të premtet muzikore
- 6- Muaji i Letërsisë dhe i Artit
- 7- Festojmë së bashku festat e fundvitit

Shqyrtroi dhe analizoi konkretisht;**A- Performanca e projekteve;**

Projektet janë të hartuara sipas një formati të duhur për hartimin e projekteve , me një kuptueshmëri të qartë dhe focus po ashtu.

Të realizueshme veprimtaritë që cojnë drejt realizimit të qëllimit dhe përfitimit në komunitet .

Të domosdoshme gjithashtu sepse gjallërojnë më tej jetën artistike, bashkëpunimin ndërinstitucional , nxitin dhe zbulojnë talente dhe jo vetëm .

1-Përshkrimi i kontekstit është dhënë sipas kriterëve ,lidhur me analizën e problemit, strategjinë e projektit dhe qëndrueshmëinë

2-Grupi i synuar është paraqitur qartë nëpërmjet pëfituesve direkt dhe indirekt

3- Projektet përmbajnë realizimin sipas qëllimit kryesor dhe objektivave mbështetëse të tij.

4- Rezultatet dhe aktivitetet:

U vu re që tek të gjitha projektet jane përcaktuar rezultatet e pritshme sipas aktiviteteve perkatese.

A- Performanca e projekteve;

B – Koha

Jepen afatet kohore përcaktuar qarte, ndërlidhur me periudhën kohore të festive të të cilat kulmojnë aktivitetin pikërisht në ditë të caktuara ,dhënë kjo në paraqitjen e projektit

C-Kostot

Jane përcaktuar kostot e nevojshme sipas cdo projekti.

Kostot janë detajuar dhe janë të vlefshme për projektin sipas zërave.

Për sa më sipër,

Këshilli Artistik pranë Bashkisë Përmet

VENDOSI:

Zhvillimin e këtyre aktiviteteve kulturore në periudhën vjetore përgjatë vitit 2026 dhe Sigurimin e realizimit të plotë të tyre sipas afateve të vendosura në projekt ;

Anëtarët e Këshillit Artistik:

Ylli Muco Specialist Kulture

Anila Mihali Poete

Mimoza Konomi Mesuese Letërsie



VENDOSI:

Ylli Muco Specialist Kulture

Anila Mihali Poete

Mimoza Konomi Mesuese Letërsie